# DËSHMI ARKIVI

**A-455771**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Këlliçi ironizon: Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri! - REPORT.AL |
| ADRESA | `https://report.al/kellici-ironizon-behu-si-roni-te-kesh-sukses-ne-shqiperi/` |
| BURIMI | report.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 15:54:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 15:44:45 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d9cafb660149d4d801a149cc02729c4441a4124978994fd6afd23093d56a36e9` |
| TEKSTI | `a02c8f1f313473df2f4b8216f0c814d35336f7b587211330d85201948ba1d8c9` |
| PAMJA | `8a1903be7582ecb14110468a7089f4ea35d3df077c5901bd74c92ad9a56a75ee` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `08655f3ab4bc2776cd9ba396bbaa2c97e2fb620a36e52df93523f9233ebaecad` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/08655f3ab4bc2776cd9ba396bbaa2c97e2fb620a36e52df93523f9233ebaecad`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Këlliçi ironizon: Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!

by Lajm Lajm — September 18, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0 SHARES Share on Facebook Share on Twitter

Nënkryetari i PD-së, Belind Këlliçi, në një postim në rrjete sociale, ka akuzuar kryeministrin Rama se po u përcjell biznesmenëve mesazhin se për të pasur sukses në Shqipëri duhet të jesh pranë tij dhe njerëzve të tij të afërt.

Duke iu referuar deklaratave të Ramës në Kuvend për biznesmenin Carlo Alberto Becchetti, Këlliçi thotë se ky i fundit po përballet me sulme të kryeministrit pasi nuk pranoi të bëhej "klient" i qeverisë.

Këlliçi e lidh këtë qëndrim edhe me çështjen e arbitrazhit prej 110 milionë eurosh që Shqipëria duhet t'i paguajë Becchettit.

Këlliçi përmend gjithashtu rastin e Behgjet Pacollit, duke deklaruar se edhe ai ndodhet në një proces arbitrazhi pas largimit nga Aeroporti i Vlorës.

Këlliçi u shpreh se në Shqipëri krijohet një situatë ku biznesmenët që qëndrojnë pranë pushtetit trajtohen ndryshe nga ata që përplasen me qeverinë.

**Postimi**

*Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!*

*Në një shfaqje si hije afër mesnatës në Parlament, Edi Rama bëri të qartë për biznesmenët, për sipërmarrësit, se si duhet të sillen, si mund të bëhen të pasur në Shqipëri, si mund të kenë sukses.*

*Ai shpalli publikisht se për të marrë para nga ai, duhet të bëhesh si miqtë e tij, klientët e tij, apo oligarkët e tij.*

*Beketi që ka fituar në arbitrazh 110 milionë euro që do paguhen nga taksat e qytetarëve më të varfër në Europë, sipas Edi Ramës është legen. Kështu e cilësoi dhe mbrëmë.*

*Beketi mund të meritojë edhe etiketime më të rënda, por problemi në këtë rast është se ai po i merr ato 110 milionë euro për shkak se nuk u bë klient i Edi Ramës. Nuk iu nënshtrua paralajmërimeve të tij, nuk e ktheu televizionin nën kontrollin editorial të qeverisë.*

*Thjeshtë nuk u bë si Roni!*

*Nëse do bëhej si Roni, Beketi me siguri se do të ishte ende duke bërë biznes në Shqipëri dhe do të ishte mik i nderuar i Edi Ramës.*

TË FUNDIT

Këlliçi ironizon: Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!
SEPTEMBER 18, 2026

E rëndë në Itali/ Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplaset për vdekje nga kamioni
SEPTEMBER 18, 2026

Kreshnik Spahiu: Nga mushkat me hashash te jahtet luksoze, metamorfoza e zengjinëve të rinj
SEPTEMBER 18, 2026

Erion Veliaj del nga qelia, shtrohet në një spital privat
SEPTEMBER 18, 2026

Zjarr në zonën e Sektorit Rinia në Durrës
SEPTEMBER 18, 2026

Bashkëshortja u arrestua për përvetësimin e 69 mln lekëve, Fetah Mataj emërohet përgjegjës në Bashkinë Durrës
SEPTEMBER 18, 2026

Makina përplaset me barrierat, plagoset një grua dhe një fëmijë
SEPTEMBER 18, 2026

Ish-bashkëshortja e dajës së Zegjine Çaushit: E mësonte ai
SEPTEMBER 18, 2026

Debati për pagat/ Rama thirrje gjyqësorit: Ejani të flasim!
SEPTEMBER 18, 2026

Spartak Ngjela zbulon 'kurën' e xhelozisë: Lëre të dashurën të shkojë me dikë tjetër
SEPTEMBER 18, 2026

*Bengjet Pacolli është dhe ai në arbitrazh. Dhe shuma që pritet të kërkojë, pasi e dëbuan nga Aeroporti i Vlorës, është më shumë se 350 milionë euro.*

*Shumë shpejt, me gjasë dhe ai do shpallet kriminel dhe legen nga Edi Rama. Sepse nuk zgjodhi modelin që Kryeministri preferon. Mund të bëhej si Roni, mund të bëhej si Gysi, mund të bëhej si Sanieli, dhe do të ishte i respektuar.*

*Mund po ashtu të bëhesh si shoku i Olsit, që bleu një tokë me 300 mijë euro, e rivleresoi për 2 muaj me 26 mln euro, dhe për 2 muaj të tjerë u bë pronar i kazinosë në mes të Tiranës.*

*Pra e vetmja mënyrë për të ecur e për të mos pasur probleme në Shqipëri është të jesh ose klient i Edi Ramës dhe njerëzve të tij të afërt, ose koordinator për punët e pisëta.*
*Kush zgjedh të bëjë rezistencë, të shkojë në arbitrazh, është armik!*

**Tags:** belind këllici

Previous Post

**E rëndë në Itali/ Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplaset për vdekje nga kamioni**

Lajm Lajm

report.al

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT

E rëndë, elektriçisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës 01
0 SHARES

02 Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin
0 SHARES

03 Skandali/ Policia rrugore shoqëron kamionët e Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit
0 SHARES

© 2025 REPORT.AL

Aktualitet / OP-ED / Politike / Rajon / Showbiz / Sociale / Shëndet / Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.